




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-34487/22 datë:15.12.2022



Npi – 01/428 datë: 22.12.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 22.12.2022, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -XII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 22.12.2022, (e enjte) në ora 09.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit; z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanije Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamed Ademaj dhe z.Rexhep Gashi. Në mbledhje përvèç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Drejtori DZHE, z.Kastriot Shabani, DPUKGJ, z.Grejtalb Emini, DSHMS, z.Isa Haxhiu, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati, zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi, znj.Gentiana Mehmeti, asistente e Kryesuesit, znj.Valmira Hoxha, praktikante dhe z.Shqiprim Hyseni, praktikant.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përrshëndeti të gjithë të pranishmit Konstataj, Kuorumin e mjaftueshmë për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.11.2022,
2. **Diskutim për keqpërdorimin e dyshuar të druve në shkolla, (Pikë Shtesë)**
3. Pyetje – përgjigje,
4. Diskutim për Raportin e performancës së Komunës së Shtimes për vitin 2021,
5. Propozim-Vendim për dhënien e Pëlqimit për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugëve publike nëngastrën P-01134-0 dhe P-01141-0 në Z.K-Carralevë,
6. Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023,
7. Formimi i Komisionit për hartimin e planit të punës, së Kuvendit dhe orarit për vitin 2023,
8. Informatë nga DZHE - Sektori i Bujqësisë (me theks të veçantë subvencionet),
9. OJQ “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur”.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimi për rendin e ditës, propozoj edhe një pikë shtesë “Propozim-Vendim për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa me anëtaren e re znj.Zejnije Velut në vend të znj.Heroina Selmanit” e cila siç dihet tani më ajo ka dhënë dorëheqje. Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës por pa propozimin e juaj. Ne propozojmë që si pikë e dytë e rendit të ditës të futet “ Diskutim për keqpërdorimet e mundshme me lëndë djegëse në shkolla”,

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, unë pajtoj me pikat e rendit të ditës me propozimin që e bëri Përparim Ramusa. Po dua që para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës të jap një sqarim për pikën e 8 ku kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar më 28.11.2022, dhe unë kam këruar që kjo pikë “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur”, të futet në rendin e ditës, mirëpo meqenëse nuk ishte në përputhje me U.A. nuk është futur. Tani është mirë që e keni futë si pikë e rendit të ditës, mirë është po ashtu që e keni bërë një draft-deklaratë, por unë po kërkoj që këtë draft-deklaratë ta plotësojmë edhe pak.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës, rrëth pikës që e ngritëm ne si opozitë, ju vetë është dashur me e futë si pikë, e ju duhet të na sqaroni. Unë e përkrahu propozimin e Përparim Ramusa.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sqaroi, se ne e kemi bërë propozimin tonë të rendit të ditës.

z.Kadri Emini; Ne i morëm dy propozime, që të dyja janë të mira, por për propozimin e Përparimit unë mendoj se duhet me qenë drejtori i DKA-së prezent në mbledhjen tjetër për me na dhënë sqarime.

z.Përparim Ramusa; Unë po befasohem me kolegët e mi deputet për votën që e kanë marrë, ku më e rëndësishme për ta është zëvendësimi i një anëtare të KPF-së se sa me diskutuar për një keqpërdorim. Unë ju lus që propozimin tim me e qitë në votim.

z.Kadri Emini; Nëse në këtë çështje ka punë hetuesia, ne nuk duhet me diskutuar, sepse po ndërhyjmë direkt në procesin e hetuesisë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë kërkoj nga Zyrtari Ligjor që të na sqaroi nëse kemi të drejtë me diskutuar për këtë çështje kur kjo është në hetuesi.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Pushtetet janë të ndara. Prokuroria i ka filluar hetimet dhe nuk duhet me ndërhynë në hetime.

z.Përparim Ramusa; Kadriu ra në kundërshtim me fjalët e veta, në fillim tha nuk kemi të drejtë me diskutuar, e pastaj tha ta lëmë për mbledhjen tjetër.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, diskutimi ynë nuk ndikon asgjë në hetuesi, kështu që diskutimi i zyrtarit ligjor nuk qëndron.

z.Rrahman Jakupi; Pushtetet janë të ndara, ne kemi pas akuza vazhdimisht nga ju, e ne nuk paskemi të drejtë me diskutua, këqyrni kontratën, kanë pru dru plepi, qershie etj.

z.Reshat Mujota; Drejtori, sidomos sot është dashur të jetë këtu. Ju vetë po e bëni të dyshimtë këtë punë, qite në votim edhe të ecim përpara.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, sa i përket pikave të rendit të ditës, le të hedhet në votim. Po na ndodhë neve si Kuvend që po vijmë në pozitë të pa lakinueshme se çka do të bëjmë. Pse po heziton zyrtari ligjor dhe po ngurron me thënë atë që duhet me thënë, plotë të drejtë kemi për me diskutuar, por pyetja është se sot ne kujt me ju drejtar këtu, sepse këtu duhet me thënë një të vërtetë. Ne nuk duhet me bërë diçka të madhe kur ne nuk e dimë se a është e madhe, pastaj e kemi edhe pikën e rendit të ditës Pyetje-Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e kam vetëm hallin nëse kemi të drejtë ose jo për me diskutuar këtë qështje meqenëse tashmë kjo është në hetuesi. Unë jam i pajtimit që nëse ka keqpërdorim të diskutojmë për te, pse jo.

z.Rrahman Jakupi; Po kemi të drejtë me diskutuar.

z.Besnik Seferi; Ne është mirë që me ra në dakordancë, dhe është mirë që neve me na dhënë sqarimin e duhur, zyrtari ligjor.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Nuk kemi një rregull të posaçme për këtë çështje. Meqenëse kjo çështje tash ka shkuar në hetime unë thash se nëse diskutohet mund të ketë interferenca në çështjen hetimore, prandaj edhe thash se më mirë është që të mos diskutohet.

z.Përparim Ramusa; Kërkoj falje që për të 4 herë po e marr fjalën. Mjetet financiare që i kemi miratuar për lëndët djegëse, ne duhet me diskutuar për to, prandaj qite në votim e vazhdojmë tutje.

z.Adem Ramadani; Përshëndetje, hetuesia nuk e ka pas mbyllur rastin e te ndjerës Hamide Magashi, por ne kemi diskutuar. Unë nuk e di që ka shkuar rasti i druve në hetuesi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e di që kontratat janë marrë nga hetuesia, dhe unë tash nuk e di se si është ndryshe kur një rast merret nga hetuesia.

z.Muhamed Ademaj; Përshëndetje, po diskutojmë për dy propozime për pika shtesë. Zyrtari ligjor na dha sqarimet dhe ne normalisht që duhet të vendosim sipas sqarimeve që i morën nga zyrtari ligjor.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Unë këtu jap mendim, dhe nuk ju detyroj juve për me marrë vendim. Në Kodin Penal shkruan “P rezymimi i pafajësisë” është i pafajshëm gjithë secili deri sa nuk është vërtetuar fajësia e tije.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Edhe një herë për procesverbal, unë po kërkoj që propozimi të shtyhet deri sa të përfundojnë hetimet, sepse nuk lejohet një gjë e tillë. Këtu mund të ketë dhe mund të mos ketë keqpërdorime.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, Kryesues je pak i pa vendosur, duhesh të jesh pak më i hapur. Ne nuk e gjykojmë këtë rast. Unë po them mos me insistua kaq shumë. Qysh ne nuk kemi të drejtë me fol, kur Kryetari irregullisht ka folur për këto çështje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 10 vota “Për” me 11 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e miratoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit, me propozimin për pikën shtesë “Propozim-Vendim për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa me anëtaren e re znj.Zejnije Veliut në vend të znj.Heroina Selmanit”**

z.Përparim Ramusa; Propozoj që propozimi im për pikën shtesë të jetë si pika e dytë e rendit të ditës.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për” me 7 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” miratoi rendin e ditës me pik me pikën e dytë shtesë “Diskutim për keqpërdorimin e dyshuar të druve në shkolla”**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.11.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime nuk pati Kryesuesi konstattoi kuorumin prej 17 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 16 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 28.11.2022.**

Pika 2 (Pikë Shtesë)

Diskutim për keqpërdorimin e dyshuar të druve në shkolla

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

z.Rrahman Jakupi; Duke u bazuar në nenin 47.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ne e kemi pa të rëndësishme që ta propozojmë për me futë si pikë të rendit të ditës edhe këtë çështje. Ne kemi disa informacione nga qytetarët se kemi keqpërdorim të 200 metrave dru vetëm në dy shkollën fillore “Emin Duraku” në Shtime si dhe në “Shkollën e Mesme Profesionale” në Shtime. Sipas kontratës përgjegjës është Menaxheri i Kontratës dhe Kryetari i Komunës. Ne kërkojmë përgjigje për këtë çështje. Kush është Menaxheri i Kontratës? Procesverbalet e pranimit të Druve? Nuk ka pas matje të druve. E dyta furnizimi është bërë me dru plepi etj. Ne dëshirojmë me ditë tërë historikun e ngjarjes. Fshehja e provave është bashkëpunim me keqpërdoruesin. Na kanë akuzuar neve për keqpërdorim. Ne po kërkojmë fakte, ndërkohë që gati qe një orë u diskutua këtu se a kemi të drejtë

apo jo. Ne kemi tē drejtë me diskutuar sa tē duam. Sa ka qenë vlera totale e projektit, pastaj edhe pér vitin 2020 edhe pér 2019, kështu që drejtori i Arsimit na ka lodhë tu na thënë pér keqpërdorime.

znj. Adelina Beqaj; Përshëndetje, qytetarët kanë votuar pér ndryshim, por nuk po vërehet ky ndryshim, kërkoi nga ekzekutivi pér me e dëshmuar tē kundërtën e keqpërdorimit.

z.Rexhep Gashi; Pikërisht e votova këtë pikë sepse nuk po dihet. Unë po e shohë një neglizhencë, se ai është dashur me ardhur drejtori i arsimit. Çështjet e mjegulluara na len një dyshim. Edhe Menaxheri e kish hekë një barrë nga veti edhe drejtorit. Pikërisht ju Kryesues e krijuat mjegullinën se a duhet me diskutua a nuk duhet.

z.Hamëz Tërshani; Nuk kam shumë me shtuar nga parafolësit, por duhet me qenë drejtori prezent. A u suspendua dikush nga puna lidhur me kontratën?

z.Përparim Ramusa; Jemi befasua me këtë lajm. Mënyra e juaj që donit me i ikë debatit më bën me dyshuar. Ky është tenderi i parë dhe tē parin e keni keqpërdorë, edhe ku pikërisht në shkolla. Hasani është marrë me këto çështje dhe e dinë gjendjen, mirëpo ky ka dhanë edhe pare tē veta pér sigurimin e druve. Veç me një shkollë janë zhdukur 80 metra dru. Kështu ka thënë punëtori teknik. Ju bëj apel hetuesisë e prokurorisë që tē merret me rastin dhe tē dënohen me dënim meritor.

z.Muhamet Ademaj; Edhe në shkollën e mesme profesionale u tha nga Rrahmani se mungojnë 200 metra dru. Unë punoj në këtë shkollë dhe nuk e kamë këtë informatë. Për sa i përket llojit tē druve, shumica e druve kanë qenë qarri dhe bungu sikurse gjithë herë, a ka pas pak dru tē llojit tē ndryshëm. Për sivjet unë kam biseduar me drejtoreshën pér sa i përket matjes së druve, e ajo më ka thënë se kjo është kompetencë e zyrtarit tē Komunës z. Armend Imeri.

z.Rahman Jakupi; Replikë, kam harruar me e përmend edhe QKMF-në. Për sa i përket llojit tē druve, mund ta vërtetojnë 2 persona se ka pas dru plepi, e që kjo është mashtrim.

z.Muhamet Ademaj; Unë pér shkollat tjera nuk e di, por unë po flas pér shkollën Profesionale ku i kam pa vetë që drutë kanë qenë Bung dhe Qarr.

z.Reshat Mujota; U thanë shumë gjëra këtu, ka pas raste që kanë pru edhe dru tē kalbëta. Unë po pres një sqarim nga Nënkyetari. Një subjekt e ka hup pushtetin pér punësime. Në Komunë ka vërejtje, sepse hapet konkurs me shkollë tē mesme. Përgjegjësia bie komplet te Kryetari i Komunës.

z.Hamëz Tërshani; Më vjen mirë që kjo kaloi si pikë, dhe po bëhet debat, dhe veç çka i ndihmon hetuesisë.

Nënkyetari, z.Faruk Beqa; Përshëndetje pér tē gjithë. Unë e kam parasysh se duhet me u përgjigje gjithë secili që mund tē ketë bërë ndonjë keqpërdorim. Hetimet kanë filluar pér këtë rast dhe ato duhet tē përfundojnë në mënyrë që ne ta dimë tē vërtetën pér rastin, sepse edhe ka mundësi tē shantazhit, e që pastaj ekziston edhe përgjegjësia e secilit edhe pér çështje tē tilla tē deklarimeve tē pa vërteta. Përgjegjësinë le ta merr ai që ka bërë far do vepre kundërligjore. Siç e dini ne po përballemi me probleme shumë tē mëdha, tri shkolla tē komunës tonë me ndërtimë relativisht tē reja, po pikojnë me tē madhe, kush është përgjegjës pér to. Pastaj 64 kamera publike në një projekt janë tē dëmtuara dhe nuk janë kthyer aty ku duhet tē jenë, këto e shumë kontrata tē tjera tē ndryshme nuk janë përfunduar si duhet, edhe pér to duhet tē epet përgjegjësi.

z.Reshat Mujota; Unë e kamë urryer që asamblisti me e punësuar anëtarin e vetë tē familjes. Asnjë anëtarë i familjes time nuk është i punësuar në Komunë, dhe ndjehem krenarë pér këtë.

znej. Albana Podvorica; Përshëndetje, më lejoni që tē ju uroj shëndet në vitin 2023, dhe po presim punë më tē mira në vitin që po hyjmë. Në vizitat që kemi bërë ne si Komitet i Arsimit në shkollën filliore në Petrovë e kanë përmend çështjen e druve se nuk kishte, kështu që ky problemi i druve ka qenë edhe më herët që ka pas mungesë tē druve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në shkollën e Petrovës, nuk mund tē shkojnë 200 metra dru brenda ditës. Për sa i përket Xhemshirit që ka thënë, është e pa vërtetë sepse ai vetë e ka pranuar se drutë nuk janë matur mirë.

znej. Albana Podvorica; Unë nuk po flas me thash e theme, por po flas me fjalët e drejtorit tē shkollës në Petrovë, sepse ai e pranoi një fakt, sepse ka dallim tē madh nëse duhen 100 metra dru e kanë ardhur 50 metra. Unë kam fol direkt me drejtorin e shkollës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e thash se aty ka qenë një keqkuptim, sepse furnizuesi ka shkuar duke e furnizuar secilën shkollë me rend.

z.Asllan Beqaj; U tha që krimet ekonomike po merren me këtë çështje. Unë jam që të dalim në teren si komision, dhe pastaj vjen dhe raporton këtu në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Nuk mundet që tani të maten drutë nga një Komision, për arsyen se një pjesë e mirë e atyre druve tani më janë djegur në shkolla.

z.Asllan Beqaj; Janë edhe raportet që i ka nënshkruar dikush për ato mjete të shpenzuara.

z.Lumni Amrushi; Unë po besoj që drejtori jonë, dinë mirë me i matë drutë.

Pika 3

Pyetje – përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

znj.Albana Podvorica; Pjetje për DPUKGJ-në, çka është bërë me irregullimin e trotuarit në atë pjesën e rrugës “Skender Salihaj” afér shkollës “Emin Duraku” në Shtime? Pjetja e dytë për DPUKGJ-në, Shkolla fillore në fshatin Davidovc nuk ka sallë sportive, kurë do të bëhet kjo shkollë me sallë sportive? Unë shprehë shqetësimin për mungesë të teksteve dhe mjeteve shkollore siç janë: Bankat, topat e mjete të tjera sportive të cilat janë të dëmtuara, a do ti siguron këto mjete? Unë i propozojë Kryetarit të Komunës që ta vizitojë këtë shkollë. Si Kryesuese e Komitetit për Arsim unë shprehu shqetësimin tim për qasjen jo bashkëpunuese të drejtoreshës së DKRS-së që kamë komunikuar me E-mail zyrtarisht me te, kështu që unë kërkoj nga Kryetari që të ndikojë në përmirësimin e qasjes të drejtoreshës karshi neve?

z.Besnik Seferi; Shqetësimi im është mungesa e drejtoreve për këtë pikë. Pjetja e parë DPUKGJ-në që lidhet me rrugën “Tranzit”, Kryetari ka thënë se kjo rrugë do të asfaltohet deri në fund të vitit gjë që nuk ka ndodh, është shqetësim i të gjithë qytetarëve të Shtimes, ata po thonë se kur do të jetë e zgjidhur kjo problematik një herë e përgjithmonë? Pjetja e dytë për DPUKGJ-në, ka të bëjë me shtrirjen e tri barrierave në rrugën “Fadil Rashiti” në Mollopolc është rrugë për disa familje dhe ato shtëpi që janë pikërisht në atë rrugë dhe kërkojnë që të bëhet shtrirja e tri barrierave? Pjetja e tretë për DSHP-në, a është paraparë ndriçimi në rrugën “Azem Hajdari” pasi që është mungesë ndriçimit a do të ketë mundësi që në fillim të vitit të ardhshëm të jetë i zgjidhur ky problem për qytetarët? Pjetje e katërt për DSHP-në në rrugën “Haxhi Zeka” në Petrovë afér gurëthyesit te firma “Vëllezërit e Bashkuar” ku nuk ka ndriçim dhe nuk ka kanalizim, a është paraparë në buxhetin e ri të vitit të ardhshëm të bëhen këto rregullime?

Pjetja e pestë për DPUKGJ-në, në rrugën “Anton Qeta” ku dihet se kanë filluar disa punime nga ish pushteti i kaluar por që ato punime kanë mbet në gjysmë ku saktësisht si preokupim i qytetarëve është se kanë mbet disa shtylla pa u vendosur, a do të bëhet zgjidhje për këtë çështje?

z.Adem Ramadani; Te pyetja e dytë nga mbledhja e -X- e kaluar unë nuk e kam bërë atë pyetje hiq. Pjetja e parë për DSHP-në, është hera e katërt e drejtorit që nuk merr pjesë në Komitet, pse? Unë nuk e di pse është formuar ky Komitet. Po lidhem me Idajetin që na ka qu në mbledhje një praktikant për me mbajte procesverbalin, dje kanë kërkuar anëtarët e Komitetit që me qenë Idajeti në mbledhje të Komitetit ai vetë. Pjetja e dytë për DSHP-në, ndriçimi nuk po bën në fshatin Reçak, kështu që po kemi problem me qenët endacak, mendoj se ky problem është te krejt jo vetëm te ne.

z.Reshat Mujota; Unë po i tërheqë pyetjet e mijë që i kam pas për secilën drejtori, por Kryetarit i propozoj që ta ketë parasysh dhe të ju bën pak presion drejtoreve që të marrin pjesë në mbledhjet e Komiteteve. Vetëvendosja ka fituar pikërisht prej gabimeve të juaja, sepse keqpërdorimet nëse janë bërë janë po nga ata njerëz që janë nga fillimi, vetëm kanë ndryshuar pozitat. Idajeti më herët ka qenë Drejtor, ka punuar prej fillimit dhe tani është zyrtar i Kuvendit, dhe e dinë këtë.

z.Muhamed Ademaj; Pyetje për Drejtorinë e Administratës, kur do të filloni procedurat për zgjedhjen e këshillave të fshatrave?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po jap një sqarim të shkurtë për Muhametin, siç e dini tani më irregulloren përfshatra e kemi bërë, jemi duke planifikuar që në pranverë të fillojmë me këtë proces.

z.Rexhep Gashi; E falënderoj Kryetarin për projektin e përfunduar në Gjyrkovic, që e kemi mirëpritur. Ne jemi dalë shumë keq për njoftimin e këtij projekti. Ne kemi kërkuar që të futet edhe pika “të ndryshme” përgjigja ka qenë se e kemi pikën “Pyetje-përgjigje”, mbi 20 pyetje nuk mu kanë dhënë përgjigje. 1. Për Pasqyrat e vdekura nuk kam përgjigje, 2. Sa leje ndërtimi janë lëshuar, 3.Pse nuk kemi ende sinjalizues, 4. A është funksionale drejtoria e inovacionit, unë i përsëris këto pyetje.

z.Gëzim Haxhiu; Pyetje për DPUKGJ-në, kur parashihet me u asfaltuar rruga “Taravillazi” në Godanc?

z.Rrahman Jakupi; Është hera e tretë që po i përsëris pyetjet. Më 25.10.2022 kam bërë kérkesë për qasje në dokumente zyrtare. Pyetja e parë për DSHMS-në, a mendoni se keni bërë shkelje të udhëzimit administrativ kur e keni punësuar Gjinekologun në QKMF-ë? Pyetja e dytë për DSHMS-në, si e vlerësoni Kontratën me Karitasin, dhe listën e punëtorëve të punësuar? Pyetja e tretë për DSHMS-në, a keni njohuri për punëtorët në QKMF-ë, a keni epilog prej Gjykate? Çështjen e druve që e patëm, ka mashtrim sepse ka pas dru tjera si plep qershi etj. Rruga Zborc – Godanc është e kualitetit të dobët. A është Kontrata me Karitasin abuzive?

znj.Besartë Musliu-Spahija; Në mbledhjen e fundit të Komitetit, drejtoresha e QKMF-së nuk na ka njoftuar se është në një takim tjetër. Pyetja e parë për DSHMS-në, a ka ndonjë konkurs të hapur për mjekët familjarë, dhe a është angazhuar në QKMF ndonjë Radiolog?

znj.Adelina Beqaj; Pyetje për DSHP-në, qytetarët po përballen me mungesë të ndriçimit, shtyllat elektrike janë e ndriçimi në përgjithësi po mungon?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përvendetje, faleminderit për pyetjet. Buxhetin e kemi pas 4200€. E kemi pas një operator të pa përgjegjshëm, ku lënda ka shkuar në OSHP-ë. E kem i një bashkëpunim me një OJQ dhe nuk e ka plotësuar asnjë kusht.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Përvendetje, për sa i përket pyetjeve të Rrahmanit, në lidhje me pyetjen për sa i përket Gjinekologut në QKMF-ë, nuk është punësim por është blerje e shërbimeve. Sa i përket abuzimeve, është e vërtetë se kanë ndodhur nga qeverisja e kaluar. Unë e kisha pyetur Rrahmanin për një gjë të tillë se blerja e shërbimeve a është në dëm apo në dobi të qytetarëve? A është mirë për ne që pjesa më fragjile e femrave të komunës tonë shtatzëna të shkojnë deri në Ferizaj për të marrë këto shërbime. Mua kjo qasje po më duket shumë e çuditshme. Për sa i përket Radiologut, ne kemi vepruar duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ ku thotë se aty ku ka Rëntgen, duhet të vepron ky shërbim. Ne kemi shpallur konkurs dhe e kemi përsëritur, për këtë shërbim por nuk ka konkurruar askush, dhe ketë e kemi ditur sepse nuk vjen asnjë radiolog me punuar aty për 450 euro, kur ato mund ti nxjerrë diku tjetër brenda natës. Ne e kemi pa të domosdoshme që në QKMF-ë të kemi një Radiolog, sepse këtë e thotë edhe Udhëzimi Administrativ. Sa i përket Kontratës me Karitasin, kjo është kontrata që e keni nënshkruar ju, dhe kjo është e vlefshme deri në muajin Prill 2023. Sa i përket pyetjes për mungesën e Drejtoreshës të QKMF-së, ajo ka lajmëruar që do të mungojë, dhe për këtë arsy e ka autorizuar një zyrtarë.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për përgjigjet, po ndërlidhem me drejtorin që keni ditë me bërë zgjidhje për Gjinekologun, por unë e kam shqetësimin për barnatoret që duhet ti furnizojnë pacientët me ilaqe, unë po kërkoj që të bëni zgjidhje edhe lidhur me kujdestarinë e barnatoreve. Te çështja e punësimeve, nevoja për punësim nuk do me thënë me e shkelë ligjin. Unë e kam një pyetje për ju drejtor, a keni lidhje familjare me doktor Beqën.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Sa i përket pyetjes për barnatoret, tash për tash ato kujdestarinë vetëm deri në ora 2 të mëngjesit. Por ju e dini që ato janë biznese private, dhe nuk mund ti obligojmë. Ne me doktor Beqën jemi miq por nuk është kjo arsyaja. Arsyaja është se banorët e komunës tonë kanë nevojë për këto shërbime radiologjike, sepse pa to nuk mund të caktohet diagnoza e sëmundjes, ne thash më parë se nuk kemi punësuar askënd në kundërshtim me ligjin por thash se kemi bërë zgjidhje duke shfrytëzuar mundësit ligjore që ofrohen me opzionin e blerjeve të shërbimeve, pikërisht për me bë zgjidhje.

z.Reshat Mujota; Barnatoret janë private, por unë e pyeti drejtorin a jeni ju i gatshëm me bë kujdestari në barnatoren e juaj?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Po sigurisht unë jam i gatshëm që të bëjmë kujdestari.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshtëndetje, sa i përket pyetjes së Besnikut, ai është projekt i kaluar që d.m.th. dy vjeçar. Rruga “Taravillazi” në Godanc do të asfaltohet në Pranverën e 2023, vetëm ajo ka mbetur. Kontraktori mund edhe të bëj lëshime, por projekti ka edhe garancinë.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Përshtëndetje për të gjithë, faleminderit për pyetjet. Sa i përket projektit të përfunduar të parkut në fshatin Gjyrkovic, atij i janë gjëzuar banorët e fshatit sigurisht fëmijë e të rritur. Për sa i përket sallave të sportit në shkollat e fshatrave Zborc dhe Reçak, ato tashmë veç kanë filluar procedurat. Shkollat në fshatrat Petrovë dhe Pjetërshticë ende nuk kanë përfunduar tërësisht, tani pra mbeten pa sallë sportive vetëm shkolla “Hasan Prishtina” në Godanc, dhe me këtë mbylljet ky cikël. Sa i përket rrugës “Tranzit” për Besnikun që po bën pyetje për publikun, në buxhetin e Kosovës të vitit 2023 janë ndarë 1.7 milion euro, dhe kjo rrugë do të kryhet përfundimisht në verën që po vjen. Për mungesën e drejtorëve në Komitete, më vjen keq, por ne do të bisedojmë me drejtorët për arsyet e mungesave të tyre, dhe ata do të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetave. Sa i përket ftjesës për përrimin e projektit në Gjyrkovic, ka ndodhur për shkak të agjendës së ngjeshur të Kryeministrit. Por ne jemi munduar që sadopak me i gjëzuar banorët e fshatit Gjyrkovic. Parku në fshatin Gjyrkovic siç e keni pa është me cilësi të lartë, ku do të vazhdojmë edhe në fshatin Davidovc. Po përmendet jo pa qëllim vëllai i drejtorit të Arsimit, doktori Efendi i cili për 40 vite i shërbeu kësaj komune pa u ndalë asnjëherë, është një cinizëm i atij që e bënë një pyetje dhe përpjekje të tillë për doktor Efendiun, që vetëm lëvdata ka për punën e tij. Sa i përket Kontratës me Karitasin, ju e dini se në vitin e parë, nuk kemi mundur me bërë zgjidhje tjeter, sepse unë besoj se nuk ka dashamirë të tillë që kishin dashur me e mbylli Çerdhen e fëmijëve, prandaj ne kemi qenë të detyruar për me e vazhduar kontratën e tillë deri sa të përfundojmë trajnimin e stafit aty. Sa i përket Kontratës së druve, unë mund të them se po bëhet shumë zhurmë për asgjë. Ju zotëri Jakupi e keni gjet një gazetarë prontist dhe një injorant që po bëni zhurmë për asgjë. Do ta shihni se nga këto intriga, do të shpërfaqen dhe do të shihet se aty nuk ka asgjë. U fol për nepotizëm, duhet ta sqarojmë se nepotizëm është me e punësuar gruan drejtoreshë sikur keni bërë ju zotëri Jakupi, sa keni qenë Kryesues e Nënkyetar i Komunës, pastaj keni dhënë tenderë, e tash me fol ti për nepotizëm është kiomet. Ju e keni humbur krejtësisht arsyen sa edhe i akuzon kolegët e subjektit tuaj, se pse keni shkuar në Vlorë me Kuvendin. Sa i përket dekorimit të qytetit, ne kemi shkuar në minimumin e shpenzimeve, por e kemi bërë me qëllim që sado pak ti gjëzojmë edhe fëmijët e rininë e komunës tonë. Jemi kujdesur që dritat të janë me sa më pak shpenzime të ulëta. Sa i përket ndriçimit publik ai do të vazhdojë edhe më shumë edhe në vendbanimet tjera.

znj.Albana Podvorica; A ke qenë ti Kryetarë ndonjëherë në shkollën e fshatit Davidovc. Godancin nuk e harrove e shkollën e Davidovcit e harrove. Këto që i thash unë janë nevoja, e këtë nuk e thash veç hajt ta them.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Faleminderit për pyetjen, unë jam dakord me ju që gjendja është e mjerë, por kjo gjendje është trashëguar ashtu nga subjekti i juaj. Në muajin Qershor i kemi nda 100.000€ për sanimin e kësaj gjendje. Jeni dëshmitarë që janë rinouar komplekt dy shkolla të mëdha në Shtime. Është intervenuar në shkollat në fshatrat Muzeqinë dhe Carralevë. Për këtë kohë që kemi pas nuk kemi mundur me sanuar gjendjen në tersi të shkollave në komunën tonë. Me kënaqësi do ta vizitoj shkollën në fshatin Davidovc përsëri dhe do të bëjmë përpjekje maksimale për të kriuar kushte normale për punë aty.

z.Përparim Ramusa; Po besoshem me ty Kryetarë, Kuvendi i ka 21 këshilltarë, dhe nuk qëndron konstatimi i juaj për “Tranzitin” sepse ju keni thënë se ky do të përfundon në verë. Erdhe me një mllef, e akuzove shefin e grupit parlamentar të PDK-së për sa i përket krimeve ekonomike, e akuzove gazetarin i cili e përfaqëson mendimin e lirë e i cili për mua është shumë meritorë. Krimet ekonomike sigurisht që kanë vërtetu se ka abuzim. E akuzon vëllaun e Rrahmanit për tender e unë jam i bindur se nuk ka marrë tender. Indirekt ti je përgjegjës, por direkt është përgjegjës ai që e ka kryer veprën, nëse e ka kryer.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Rrugën “Tranzit e kemi pas prioritet, dhe për këtë rrugë shumë shpesh kam shkuar në Ministri, vetëm e vetëm për me rregulluar këtë rrugë. Në verë nuk ka ndodhur rregullimi i sajë sepse nuk ka kaluar në rialokim. Tash ky projekt është miratuar në Buxhet dhe është bërë Ligj. Sa i përket shtëpisë mediale “Koha” nuk ka subjekt që e çmon më shumë se sa Vetëvendosja, por gazetari është shqetësim i yni sepse është i njëanshëm e tendencioz, i cili vjen me gjëra të tilla 6 javë pasi është përfunduar çështja e furnizimit të druve, mirëpo unë do të flas me anëtarët e mediumit për tua bërë me dije se qoftë për dru ose për çfarëdo tjetër secili që dëshiron, e edhe prokuroria i ka dyert e hapura që të vjen dhe ta shikon tërë dokumentacionin. Unë i siguroj qytetarët e Shtimes se në komunën tonë po qeveriset mirë dhe drejt. Në fakt kjo tregon se kur nuk keni me çka të merreni ju merreni me llojet e druve jo ahu jo plepi etj.

z.Rrahman Jakupi; Ne nuk jemi këtu për me na bërë ju pyetje neve drejtor, por ne u bëjmë pyetje juve e ju përgjigjeni, me marrëveshjen e Karitasit nuk ka pas Gjinekolog. Ndërsa ti Kryetarë është hera e parë që ma përmend bashkëshorten, sepse ajo punon në institucion te ti, e unë nuk jam lahper sikurse ti, e çështja e nepotizmit, tash kanë me të dalë në shesh me rendë. E çështja e vëllait drejtohu me padi në gjykatë nëse ke argumente. Sa më përket mua unë jam përgjegjës për me dalë para mediave.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kërkoj nga ju zotri Rrahman Jakupi që ta tërhiqni fjalën që e thatë (lahper) për Kryetarin e Komunës.

z.Rrahman Jakupi; Ky është diskutim i imi e thashë një herë e nuk e them dy herë, edhe unë kamë fjalë kogjo mirë për bashkëshorten tënde, por unë nuk i hy kësaj çështje sepse zotërit nuk hyjnë në kësi çështje, nëse donë mundemi me fol privatish, mirëpo kjo vlen për ty dhe për të gjithë të tjerët se kjo është politikë e Vetëvendosjes. Çështja e nepotizmit u diskutua, dhe nëpër gjykata, se ti e din që gjatë zgjedhjeve se ti ndoshta je shumë burrë i mirë, por Kryetar nuk je, nuk e ke menaxhuar mirë, është kohë e pozitës fatkeqësisht ju kanë mbet edhe 3 vjet, ju do të shkoni në shtëpi. Unë i kam 9 ylla, anëtarë të kuvendit, jam shumë krenar për punën e tyre a vijnë a nuk vijnë në Shqipëri është pune e tyre. Unë jam përgjegjës për me dal para mediave jam njeri socio.... dhe mediat i respektojmë, po ai Ademi që e përmende është një gazetar profesionist, neve na ka sulmuar kur kemi qenë në pushtet, por ne nuk e kemi thirr Flaken me ndërhy në punët e Kuvendit. Sa për informatën tuaj jam i sigurt që shumicën e gjëra nuk i din dhe ki skandal me boca të shkollave ja keni ngjit tiketën fallc, mirëpo nuk guxonasi me publiku. Kur po flisni ju për nepotizëm, drejtori e ka mikun, drejtori tjetër vëllain, asamblistit tjerë Migjen, asamblistë tjetër kunatën, koalicion qeveritar, kushërirave dhe kushërire, ju ke dhënë subvencione. Këto janë krejt këto që ti ke dështua ke premtua meritokraci, krejt drejtorët e shkollave i ke bërë drejtorë me të kaluar politike, ti mundesh me qenë shumë djalë i mirë por Kryetar jo deri tash e ke dëshmuar, mu po më vjen keq.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Lidhur me shkeljet ligjore që po përmenden, ne kemi kërkuar nga Ministria, punësim të Gjinekologut, por Ministria na ka kthyer përgjigje dhe ka thënë se nuk lejohet. Por ne kemi zgjedhur një rrugë tjetër të blerjes së shërbimeve që është e lejuar. Se ka qëlluar që të jetë miku im doktor Beqa po ashtu edhe doktor Efendi me një përvojë shumë vjeçare që kemi punuar bashkë mendoj se kjo nuk duhet të jetë ndonjë pengesë sepse ju e dini shumë mirë se sot nuk mundesh me gjetur specialist me përvojë kaq të gjatë që vjen e punon në QKMF për 450€. Unë mendoj se ju duhet të kërkoni falje nga ata që po i etiketoni.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; U bënë disa ofendime, që janë instaluar nga ju tash e disa vite, kësot lloj fjalësh vulgare të nivelit shumë të ulët të cilat vetëm ju mund ti thuani. Me këto fjalë ju po e tregoni gjendjen e juaj emocionale shumë të ulët, po e tregoni nivelin e ulët të kulturës së juaj. Një njeri si ju që ka qenë Nënkyetarë i Komunës e i cili ka qenë sinomim i nepotizmit, ky është problemi yt. Po detyrohem me u marrë me kësot diskutimesh sa do që unë kam pas dëshirë që këtë seancë të Kuvendit me e mbyllë në atmosferë festive të fund vitit.

Pika 4

Diskutim për Raportin e performancës së Komunës së Shtimes për vitin 2021

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Te rapporti i performancës ne e kemi dërguar, kërkoj një detaj nga Kryetari për këtë e pastaj me bë pyetje. Unë në vazhdim e propozoj një pauzë për drekë.

z.Muhamed Adfemaj; Mendoj se ky rapport është një obligim ligjor që e kemi për ta analizuar, kështu që ne si grup parlamentar i LDK-AKR jemi për Raportin.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mirë, pasi që diskutime të tjera për këtë pikë nuk ka e përfundojmë këtu në ora 12:15h dhe vazhdojmë pas Pauzës së Drekës me pikën e pestë në ora 13:45h.

Pauzë deri në ora 13:45h.

Pika 5

Propozim-Vendim për dhënien e Pëlqimit për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugëve publike në ngastrën P-01134-0 dhe P-01141-0 në Z.K-Carralevë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Vazhdojmë mbledhjen e Kuvendit pas pauzës në ora 13:45h ku e konstatoj Kuorumin prej 17 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Fillimisht ju njoftoj se për këtë pikë KPF-ja unanimisht i rekomandon Kuvendit aprovimin e kësaj pike. Në vazhdim fjalën për prezantimin e kësaj pike ja jap drejtitorit Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përvendetje, ne e kemi marrë një kërkesë nga Kompania "Kastrioti" – Carralevë, e cila ka kërkuar Pëlqim për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugës në ngastrat me numër P-01134-0 dhe P-01141-0 në Z.K-Carralevë, e cila gjendet në mes të pronave private ku kjo kompani operon dhe bënë shfrytëzimin e gurit natyror për nevoja të biznesit të sajë. Për ta bërë më të quartë për ju kjo rrugë që po flasim do të mbetet aty ashtu si është por do të nivelizohet dhe funksionalizohet në përputhje me nivelin e sipërfaqeve të ngastrave në të cilat kjo Kompani është duke operuar. Ruga do të jetë e hapur dhe e kalueshme për të gjithë pa dallim, unë ju ftoj që ta aproponi këtë vendim.

z.Përparim Ramusa; Te kjo pikë ne si subjekt i PDK-së e mbështesim, por ju si Vetëvendosje ende nuk jeni mbushur mend. Ne i përkrahim bizneset duke i respektuar rregullat.

z.Rershhat Mujota; Edhe unë e mbështes sipas rekomandimit të KPF-së, por perime është drejtuar gishti kah pozita e atëhershme.

z.Besnik Seferi; Unë po e kundër-argumentojë atë çka e tha Përparim Ramusa, sepse ne jemi ata që i përkrahim bizneset, pra ne jemi ata që i kemi përkrahur edhe pse ishte në fushatë zgjedhore, ne i kemi përkrahur ato pesë bizneset që u janë dhënë tokat në Davidovc. Kemi pra një sqarim konkret nga drejtori se për çka e ka bërë kërkesën kjo kompani.

z.Përparim Ramusa; Këta jo veç që janë kundër por q'do leje që kanë dhënë Kryetari ka thënë se kemi me i rishikuar. Keni folur shumë edhe për firmën "Ardhmëria".

z.Besnik Seferi; Unë vetë kamë thënë se nuk duhet me pas nënkontraktor, dhe kam pyetur se pse duhet me pas vetëm një Kompani e cila gjithherë i merr tenderët, duhet me u krijuar mundësia edhe firmave të tjera. Prandaj unë jam i mendimit se ç'do vendim Kuvendi duhet me i rishikuar.

z.Muhamed Ademaj; E përkrahu kërkesën e kësaj Kompanie, mirëpo në atë rrugë jo me pas qasje vetëm kompania por edhe të gjithë qytetarët.

z.Reshat Mujota; Nuk qëndron ajo që tha Besniku, sepse firmat kanë ardhur me projekte konkrete. Ju në emër të Vetëvendosjes duhet me i kërkuar falje Kompanisë.

z.Përparim Ramusa; Replikë, tani ka me i kërkuar falje Besniku, Kompanisë.

z.Besnik Seferi; Faleminderit, për ata që po më rinë gati për kërkim falje. Unë qëndroj pranë asaj që e kam thënë se pse një Kompani gjithherë duhet me fituar tender, pse mos me fituar edhe ndonjë Kompani tjetër.

znj.Zejnije Veliu; Përvendetje, jemi këtu në Kuvend duke shqyrtuar kërkesën e Kompanisë "Kastrioti" nga Carraleva, për të cilën ne duhet të vendosim a ta aprovojmë apo jo, kështu që mos të

merremi tani me firmat tjera, sepse për ato të tjerat mundeni edhe privat me debatuar. Mendoj se këtë kërkesë duhet ta përkrahim.

z.Rahman Jakupi; Meqenëse këtu po shkruan se është e evidentuar si pasuri e rrugëve të pa kategorizuara, sa e di unë Drejtoria është dashur me dhënë Pëlqim, e mos me ardhur në Kuvend.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUGKJ; Në drejtori zyrtarët e kanë analizuar kërkesën, kështu që ne si drejtori nuk lëshojmë Pëlqim, përvèç Kuvendit. Sa i përket përkrahjes së Bizneseve unë mund të ju them se zyra ime përkatësisht drejtoria është 100% në përkrahje të bizneseve.

z.Rexhep Gashi; Drejtori tha unë jam për me i përkrahë bizneset. Por jo kështu, "Ardhmëria" i ka 100% punëtorët nga komuna e Shtimes.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Është mirë që kemi kompani gjigante, por mos harroni se kemi edhe kompani që kanë falimentuar, e ne duhet të mendojmë për të gjitha, në vazhdim konstatoi kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës, në mbledhjen të mbajtur më 22.12.2022, unanimisht miratoi vendimin për dhënien e Pëlqimit për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugëve publike në Ngastrat Kadastrale Nr. P/01134-0 me sipërsaqe 1,694 metër katror dhe Nr. P/01141-0, me sipërsaqe 979 metra katror, në Zonën Kadastrale – Carralevë, evidentuar "Pasuri Shoqërore – rrugë e pakategorizuar", Kompanisë "Kastrioti" O.P – Carralevë, Komuna Shtime, me pronarë z.Kastriot Fazlja.**

Pika 6

Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E njoftoi Kuvendin me rekomandimin e KPF-së dhe po ashtu e njoftoi Kuvendin me një kërkesë të Drejtorisë për Shërbime Publike e cila ka ardhur nga KRM "Pastërtia" njësia në Shtime për ngritjen e disa çmimeve të shërbimeve që i kryejnë ata. Unë mendoj se kjo Draft-Rregullore duhet të shkojë në diskutim publik ku do të ketë mundësinë secili që të bëj propozimet e veta, dhe prapëserapë do të kthehet në Kuvend për miratim, mirëpo fillimi i ja përfundim fjalën z.Bujar Feratit, për prezantimin kësaj pike.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Përshëndetje, të gjitha ato që u desh ti thosha unë i thave ti Kryesues, unë nuk kam diçka më tepër për me shtuar, materialin e keni marrë me kohë nëse ka ndonjë pyetje unë jam gati të përgjigjem. Jam i mendimit se ky draft sot duhet të shkojë në diskutim publik.

z.Hamëz Tërshani; Unë e kam lexuar materialin. Pse nuk është këtu drejtori për me na dhënë disa sqarime të cilat na nevojiten, për arsyet se kjo ndikon drejtpërdrejt në xhepin e qytetarit.

z.Reshat Mujota; Kemi këtu një kërkesë nga KRM "Pastërtia" të cilën unë e përkrahu, mirëpo ajo që nuk më ka pëlqyer është se inflacioni përvèç Kompanisë ka ndikim edhe te qytetarit.

z.Zejnije Veliu; Unë i përkrahu parafolësit, mirëpo unë kërkojë nga drejtori që të na jep sqarime më shumë për sa i përket borxheve të Kompanisë Publike "Pastërtia".

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës, në mbledhjen e mbajtur më: 22.12.2022, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra Komunale për Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 7

Formimi i Komisionit për hartimin e planit të punës, së Kuvendit dhe orarit për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Qelës për formimin e Komisionit është 5 anëtarë. Hapi diskutimin dhe i pres propozimet e juaja.

z.Sanije Sadiku; Ne nga Vetëvendosja e propozojmë z.Gëzim Haxhiun.

z.Përparim Ramusa; Për mos me e zgjatë shumë, unë propozoj që ata që kanë qenë më herët në Komision për vitin 2022 të jenë po ata edhe kësaj here.

z.Rexhep Gashi; Unë e propozoj z.Muhamed Ademaj, arsyeva që se ka përvojë më shumë.

z.Kadri Emini; Unë e përkrahу propozimin e Përparimit që të jenë të njëjtë.

***Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2022, unanimisht miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023, në këtë përbërje: Hamëz Tërshani, - (PDK), Sanije Sadiki, - (LVV) dhe Rrezartë Ramadani, - (LDK).**

Pika 8

Informatë nga DZHE - Sektori i Bujqësisë (me theks të veçantë subvencionet)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Kastriot Shabani.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Pasi përshtëndeti të gjithë të pranishmit lexoi informatën. Informatën e keni marrë me kohë në formë të shkruar dhe e keni lexuar, (Shih dokumentin) nëse ka ndonjë pyetje unë jam i gatshëm të përgjigjem.

znj.Adelina Beqaj; Faleminderit për raportin, unë kam një pyetje, se deri ku ka arritur vlerësimi për dëmet e shkaktuara nga vërvshimet? Dhe pyetja e dytë e është duke vazhduar projekti i Kolektorit?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Sa i përket pyetjes së parë, po ne vlerësimin e dëmeve e kemi bërë dhe e kemi dërguar në Ministri, tanë po presim se çka do të vendos Ministria, lidhur me pagesat. Sa i përket projektit të Kolektorit po është duke vazhduar.

z.Muhamed Ademaj; Faleminderit për Informatën, edhe në Komitet e kemi pas informatën nga sektori i bujqësisë, ku thanë se janë planifikuar të mbillen me drithëra të bardha rrëth 1200 hektarë në Komunën tonë, po ashtu na njofuan se përmbylljen e një hektari me grurë shpenzimet mesatare janë sjellë rrëth 550€. Te subvencionet Qeveria i ka subvencionuar me nga 350€ për hektarë. Është mirë me i dhënë më shumë prioritet bujqësisë. Shqetësimi im por edhe i qytetarëve tjerë është degradimi i tokës bujqësore.

z.Rexhep Gashi; Faleminderit drejtor për prezencën e juaj publike. Këputë jemi tu i akuzuar PDK-në për emrat e përfituesve të subvacioneve. Tash nuk i kemi këtu në listë.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Të gjithë emrat e përfituesve të subvacioneve i ke në Web-faqen e Komunës.

z.Reshat Mujota; Unë e kam pa Web-faqen dhe i kamë lexuar, aty janë të gjithë emrat e përfituesve të subvacioneve. Unë po kërkoj nga drejtori, se a kanë mundësi me u subvencionua bujqit nga mjetet e buxhetit të komunës? Dhe pyetja e dytë është a ka pas ankesa për sa i përket ndarjes së këtyre 40 serrave, nëse ka pas sa ankesa janë?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Sa i përket ankesave, jo nuk ka pas asnjë ankesë.

z.Kadri Emini; Faleminderit për Informatën, edhe unë desha të pyes për ankesa, tha që nuk ka pas ankesa. Është mirë, sepse ekziston një opinion pozitiv për punën e juaj. Kjo ka qenë shumë transparente bile unë e kam pa që thirrja për konkurrim ka qenë e shpallur edhe në faqen personale të juaj të F.B prandaj ju përgëzoj për punën e juaj.

z.Lumni Amrushi; E pashë datën ishte 23 ju thatë se ka pas afat ankesë 8 ditë, nuk është 8 ditë por vetëm 5 ditë afat ankesë, kjo transparencën e ka zbehë pak.

znj.Albana Podvorica; Faleminderit për Informatën, pyetje për drejtorin, a ka pas ankesa në projektin për ndarjen e mëshqerrave? Më duket se për ankesat është dashur me shkuar në Prishtinë.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Ne nuk kemi pas të drejtë për me qitë diçka lidhur me ankesat, sepse mjetet qind për qind i ka dhënë një OJQ.

z.Rrahman Jakupi; Sa e vlerësoni se në këto komisione kanë qenë njerëzit profesionist. 20% e buxhetit ka qenë i Komunës.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Për të gjithë zyrtarët unë kam respekt, sepse e kryejnë punën mirë. Zyrtari, Ejup Ismajli nga sektori i bujqësisë, nuk ka dashur me u përfshi në Komision edhe pse unë e kam ftuar. Ndërsa sa i përket zyrtarit Bashkim Ahmeti, ky veç është në një komision tjetër për

ndarjen e subvencioneve dhe Rregullorja e punës që e kem nuk e lejon që me qenë në dy Komisione për ndarjen e subvencioneve. Sa i përket IADK-së kanë qenë 10 përfitues, sa keni qenë ju në pushtet, ndërsa tani janë 13 përfitues pas jush. Dhe mund të ju them se Komisioni ka qenë po ai në përbërjen e njëjtë kur e keni zgjedhur ju.

z.Besnik Seferi: Ka qenë dashur me na ardhur një informatë më e gjerë.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Kjo informatë është vetëm sa i takon sektorit të Bujqësisë.

z.Besnik Seferi; A ka me vazhduar ky projekt i serrave? Çka ka ndodhur me bizneset e komunës së Shtimes, ku shumica e bizneseve janë dëmtuar nga reshjet e shiut?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Te vlerësimi i dëmeve janë përfshirë edhe bizneset.

z.Rexhep Gashi; Nuk dyshova në punën e juaj dhe të Komisionit, por materialin duhet me na e dërguar 7 ditë përpara.

z.Reshat Mujota; Te përfituesit e projektit “Mëshqerrat” a e ka bë përzgjedhjen Komisioni, apo e ka bërë OJQ?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; 76% të mjeteve i ka pas OJQ-ja ndërsa 24% Komuna, ndërsa Komisioni ka qenë i kombinuar.

Pika 9

OJQ “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur”

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Reshat Mujota e ka propozuar këtë pikë edhe në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të cilën e kemi mbajtur në Vlorë, por atje nuk kemi mjujt me futë si pikë me qëllim që të përgatitemi më mirë, meqenëse është pikë e ndjeshme. Tani ne në këtë mbledhje e kemi futë si pikë të rregullt të rendit të ditës dhe së bashku me stafin e kemi përgatitur një Draft-Deklaratë, të cilën e keni marrë me material dhe po besoj se e keni lexuar. Unë fillimi shqiptar do të ja kaloj fjalën Reshatit që ta bën një prezantim të kësaj pike meqenëse është në rrjedha dhe pastaj do ta hapi diskutimin.

z.Reshat Mujota; Unë jam anëtarë i kësaj Shoqate dhe e di se është duke u përgatitur dhe është duke u bërë fushatë që Lulëkuqja me katër petalet e sajë të jetë simbol unik i Gjenocidit që ka ndodhur në Kosovë, nga Serbia. Kësaj shoqate i prinë veprimitari i çështjes kombëtare z.Bardhyl Mahmuti. Po punohet me të madhe edhe në diasporë por edhe në Kosovë që ky simbol të jetë unik për krejt Kosovën me të cilin do të prezantohet në botë se Kosova ka përjetuar Gjenocid nga Serbia, gjatë luftës në vitet 1998-99. Në vazhdim nga foltorja e Kuvendit tregoi fotografinë e Simbolit të Gjenocidit (Lulëkuqen). Unë e kam lexuar draftin e deklaratës të cilin e kishin përgatitur mjaft mirë por unë po propozoj që te pika e 4 e saj të shtojmë edhe disa fjali, në të cilat do të thuhej shprehimi shqiptar “Kuvendi i Komunës së Shtimes përkrahë kërkosë e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur” që Lulëkuqja me katër petale të jetë simbol unik për ta kujtuar Gjenocidin në Kosovë”.

z.Muhamed Ademaj; E falënderoj asamblistin z.Mujoten për këtë informatë. Atë që bëri Serbia në Kosovë në vitin 1997 dhe 1999 është Gjenocid në shqiptarë i ushtruar në forma të ndryshme si djegie shkatërrime, ne si grup LDK dhe AKR e mbështesim deklaratën Gjenocidi në Kosovë dhe e mbështesim Lulëkuqja me katër petale të jetë simbol unik për ta kujtuar Gjenocidin në Kosovë.

z.Përparim Ramusa; E përvihendës Reshatin për Iniciativën, po ashtu i përvihendës dhe i përkrahu dy patriotët dhe veprimitarët e çështjes kombëtare Bardhyl Mahmutin dhe Adnan Asllanin, pajtohem me deklaratën e përpiluar nga Kuvendi Komunal me sugjerimet që Reshati pak më herët i potencojoë edhe besojë që do të inkorporohen në deklaratë.

z.Rahman Jakupi; E përkrahu këtë deklaratë, edhe po ashtu i përkrahu patriotët Bardhyl Mahmutin, Adnan Asllanin dhe në veçanti Ramush Buja. Unë propozoj që me u futë përvicë, Reçakut edhe familja Asllani, sepse aty ka pas edhe një foshnjë. Po ashtu edhe duhet të përfshihen edhe dhunimet e forcave serbe, sepse edhe këto janë krimë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kjo deklaratë është bërë nga profesionistët më të mirë, ku mendoj se është gjithëpërfshirëse dhe e përkrahë simbolin unik të Gjenocidit në Kosovë. Unë e kam sjellur në Kuvend vetëm si draft.

znj. Albana Podvorica; Unë konsideroj se kjo është pikë e ndjeshme, prandaj unë dua të shpreh qëndrimin tim se e përkrahu deklaratën dhe jam që lulëkuqja me katër petalet të bëhet simbol i Gjenocidit, pasi që ka ndodhur Gjenocidi në të vërtetë në Kosovë, duke kujtuar me këtë rast edhe gratë e dhunuara gjatë luftës më 1998-99.

z.Adem Ramadani; E përkrahu Reshatin por edhe Organizatën për këtë iniciativë. Nuk pashë ndonjë datë të caktuar kur do të formohet simboli dhe si do të përdoret.

z.Reshat Mujota; Kjo është kërkesë edhe për institucionet qendrore. Në momentin që e aprovon Qeveria, është valide. Mendoj se ne mundemi me e përkrahur këtë iniciativë. Unë do ta marr përsipër që ta sjelli simbolin e lulëkuqes, mirëpo unë nuk mundem me thënë diçka konkrete për datën.

z.Adem Ramadani; Unë pyeta se a ka një datë të caktuar se kur ka me u përdorë simboli?

z.Reshat Mujota; Masakra e Reçakut njihet ndërkombëtarësh, por ka edhe masakra të tjera, kështu që ky simbol ka me qenë për të gjitha masakrat, dhe ne si Kosovë kemi me u identifikuar me këtë simbol (Lulëkuqja me katër petalet).

z.Besnik Seferi; Faleminderit për iniciativën. E dimë që Serbia ka kryer Gjenocid në Kosovë e ende nuk është dënuar. Përveç Kuvendit të Kosovës askush tjetër nuk ka miratuar ndonjë dokument për ta denuar Gjenocidin në Kosovë. Pajtohem me këtë deklaratë dhe do ta votojmë.

z.Reshat Mujota; Kjo shpallet me rezolutën e Kuvendit të Kosovës, kështu që normalisht që do të jetë simbol përvëç të tjerave edhe për 15 Janarin dita e masakrës së Reçakut.

z.Rexhep Gashi; Përhëndetje për iniciatorin dhe për Shoqatën, Serbia kreu gjenocid në Kosovë e ende nuk po e njeh bota. Ne si Kuvend me miratimin e kësaj deklarate mund të kontribuojmë sado pak.

z.Kadri Emini; Ju përgëzoj për iniciativën e marruar nga Reshat Mujota. Ne kemi bërë shumë pak për gjenocidin në Kosovë. Akademia e Shkencave të Kosovës nuk ka asnjë libër për këtë. Ne duhet të bëjmë shumë më shumë për përhapjen e të vërtetës për gjenocidin e bërë Serbia në Kosovë. E përkrahu simbolin e Lulëkuqes sepse kjo është simbol i vendit ku është derdhur gjaku për liri, dhe thonë se kjo mbinë pikërisht në vendin ku është derdhur gjaku i dëshmorëve për liri.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi tekstin e draft-deklaratës, si dhe pjesën shtesë të propozuar nga Reshat Mujota, (Shih dokumentin e draft-deklaratës).

z.Rrahman Jakupi; Mendoj se duhet të futet në deklaratë edhe dhunimi i grave në komunën e Shtimes vrasja e 21 fëmijëve si dhe familja Asllani.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2022, unanimisht miratoi Deklaratën, si vijon:**

1. Kuvendi i Komunës së Shtimes do të jetë gjithmonë pjesë e angazhimeve për përhapjen e të vërtetës, për Gjenocidin që ka ndodhur në Kosovë, gjatë luftës të vitit 1998-1999, por jo vetëm, si dhe për ndëshkimin dhe dënimin e krimeve të kryera nga shteti i Serbisë ndaj popullit shqiptar.

2. Gjenocidi do të mbetet plagë e hapur derisa autorët e tij mbeten të pandëshkuar, të padënuar dhe aq më keq pa ngritjen e aktakuzave nga cilido nivel, vendor apo ndërkombëtar. Gjenocidi është plagë e hapur edhe përfaktin se ende kanë mbetur pa u gjykuar dhe dënuar krimet dhe gjenocidi i kryer ndaj popullatës civile në komunën e Shtimes e veçmas në fshatin Reçak, ku më 15 Janar 1999, forcat serbe kryen aktin Gjenocidit, gjatë të cilit u masakruan 42 civilë shqiptarë e njohur si krimi më i rëndë që njeh njerëzimi - "Masakra e Reçakut".

3. Ne bashkohemi dhe do të jepim kontributin tonë në përhapjen e të së vërtetës dhe kërkimit të drejtësisë për viktimat e Gjenocidit në Kosovë duke kërkuar përgjegjësi para drejtësisë ndërkombëtare, dënimin dhe zbardhjen e krimeve të bëra nga Serbia, sipas "Konventës, për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, 9 dhjetor 1948" si dhe "Konventa e IV e Gjenevës për mbrojtjen e Personave Civil në kohë Luftë, si dhe Protokolleve Shtesë I dhe II të vitit 1977".

4. Kuvendi i Komunës së Shtimes përkrahë kërkesën e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur” që Lulëkuqja me katër petale të jetë simbol unik për ta kujtuar Gjenocidin në Kosovë. Gjithashtu i bashkohemi çdo lloj aktiviteti që i kontribuon përhapjes të së vërtetës dhe kërkimit të drejtësisë për viktimat e Gjenocidit.

z.Reshat Mujota; I përvendoset që gjithë përkrahë kërkesën e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur” që Lulëkuqja me katër petale të jetë simbol unik për ta kujtuar Gjenocidin në Kosovë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju falënderoj përkrahë kërkesën e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur” që Lulëkuqja me katër petale të jetë simbol unik për ta kujtuar Gjenocidin në Kosovë. Gjithashtu i bashkohemi çdo lloj aktiviteti që i kontribuon përhapjes të së vërtetës dhe kërkimit të drejtësisë për viktimat e Gjenocidit.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi